



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: 28.07.25		
Prilmbeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtet, ca Dodatë
05-453/01-385/0		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 28.07.2025

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ – të

Bazuar në Rregulloren e MF – NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Drejtoresha e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, me Seli në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në fushën e rinisë.

1. Ky institucion ofron mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/programave të OJQ-ve Implementimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunën e Lipjanit.
2. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një(1) projekt që kontribuojnë në **Implementimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Lipjanit. si dhe implemetimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunën e Lipjanit .**
3. Vetëm për një (1) vit.
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 38,000.00 €

Mjetet do të terhiqen nga kodi Subvencione për entitete jo publike.

5. Përfitues do të jetë një (1) OJQ për Implementim të Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Lipjanit 2025-2030. si dhe implemetimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunën e Lipjanit.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 501.00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 38.000,00 €.

6. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 15.08.2025

7. OJQ-të mund të aplikojnë me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është 1 vjeçar.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e rinisë. OJQ- të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ i ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: pranvera.i.krasniqi@rks-gov.net

Anila Reçica Llugini
Drejtoreshë e DKRS-së

